

Tiranë, 09.07.2020



## **CV Genc Sulcebe**

Genc Sulcebe ka filluar aktivitetin shkencor në fushën e Mjekësisë dhe vecanërisht në atë të *Imunologjisë* dhe *Imunogjenetikës* gjatë formimit të tij doktorat pas-universitar në Francë, gjatë viteve 1983-1986. Gjatë kësaj kohe ai ka kryer punime shkencore origjinale me impakt ndërkombëtar në studimin e përgjigjes imunitare në të sëmurët në infeksion me virusin HIV dhe rezultatet e këtyre studimeve janë publikuar në revista shkencore të njohura ndërkombëtare.

Gjatë periudhës së studimeve në Francë ka marrë titullin më të lartë shkencor për mjekët që studiojnë në fushën e Biologjisë Humane sic është "*Diploma e Studimeve dhe Kërkimeve në Biologji Humane, Imunologji - Drejtimi Imunopatologji dhe Imunogjenetikë*". Gjithashtu ka përfunduar me sukses dhe "*Certifikatën e Imunologjisë së thelluar*" të Institutit Pastër, një nga më të njohurit në botë në fushën e Imunologjisë.

Me kthimin e tij në Shqipëri ka vazhduar punën shkencore dhe akademike me ngritjen e *Shërbimit Kombëtar të Imunologjisë* si disiplinë e vecantë shkencore dhe diagnostike si dhe me ngritjen dhe organizimin e *Lëndës së Imunologjisë* si në Fakultetin e Mjekësisë ashtu dhe në atë të Shkencave të Natyrës. Njëkohësisht, nga viti 1987 deri 1991 ka drejtuar dhe organizuar Institutin e Pediatriisë në Tiranë si qendra e vetme kërkimore në këtë fushë në Shqipëri.

Gjatë kësaj kohe ai ka punuar dhe për projektin kërkimor mbi studimin e rolit të llojeve të ndryshme të autoantitropave antibërthamore në sëmundjet autoimune reumatizmale. Në vitin 1991 ka fituar gradën shkencore "Doktor i Shkencave" si rrjedhojë e mbrojtjes së punimit shkencor "*Rëndësia diagnostike e përcaktimit të antitropave antibërthamore, komplekseve imune qarkullues dhe antigjenëve HLA të Klasës së parë në sëmundjet e reumatizmit*". Titullin Profesor e ka fituar në vitin 1994.

Duke filluar nga viti 1988 - deri tani, është Pedagog me kohë të plotë në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Tiranës, Shef i Lëndës së Imunologjisë së këtij Fakulteti si dhe Shef i Shërbimit të Imunologjisë dhe Pajtueshmërisë Indore pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë. Nga 2007 deri 2012 ka mbajtur postin e Zv. Dekanit për anën shkencore në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Tiranës. Gjatë kësaj kohe ka hartuar programet e doktoraturave dhe specializimeve pasuniversitare në këtë Fakultet si dhe ka drejtuar proceset e marrjes së gradave dhe titujve shkencorë si dhe aktivitetin kërkimor-shkencor në këtë fakultet. Nga viti 2012 deri 2016 ka kryer funksionin e Kryetarit të Komisionit Kombëtar të Etikës Mjekësore pranë Ministrisë së Shëndetësisë.

Ka hartuar dhe drejton aktualisht programet e Lëndës së Imunologjisë për studentët e Fakultetit të Mjekësisë si dhe ka hartuar dhe realizuar programin e lëndës së Imunologjisë për studentët e vitit të V të Degës Biologji Speciale të Fakultetit të Shkencave të Natyrës në vitet 1988-93.

Ka drejtuar dhe drejton programet e Lëndës së Imunologjisë për të gjithë specializimet pasuniversitare. Ka qënë anëtar i Komisionit të posacëm të Fakultetit të Mjekësisë për mbrojtjen e gradave shkencore si dhe anëtar i Këshillit shkencor të Fakultetit të Mjekësisë që prej vitit 1988.

Ka realizuar mbi 20 oponenca dhe reçenca dizertacionesh dhe tekstesh shkencore si dhe ka drejtuar 7 tema disertacioni të përfunduara me sukses për mbrojtjen e grades shkencore "Doktor i Shkencave", 5 tema për shkallen SHPU si dhe disa punime diplome në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, dega Biologji.

Gjatë aktivitetit kërkimor post-doktoral në Gjermani (1991-93), Universiteti Erlangen-Nuerenberg, në kuadrin e Fondacionit "*Alexander von Humboldt*", ka kryer punime origjinale lidhur me praninë e antitropave anti-neuronale në të sëmuret me sëmundje të ndryshme

autoimune reumatizmale. Në fushën e Imunologjisë ka hapur drejtime të reja në Shqipëri: *Imunologjia qelizore; Studimi i thelluar i shënjesve autoimune në sëmundjet sistemike të indit lidhor; Immunopatologjia pediatrike me fokus në diagnozën e saktë të deficiteve imunitare të lindura dhe të fituara; Fenotipizimi imunologjik multiparametrik i leukozave dhe sëmundjeve të tjera të gjakut apo indit limfoid me anë të citometrise me fluks.*

Ka realizuar përcaktimin imunologjik dhe seroepidemiologjik të gjëndjes imunitare ndaj agjentëve infeksioze problematike si *M. Leprae, Leishmanioza, Tuberkulozi, Bruceloza, Pneumokoku, Tetanos, Pertussis, Hepatitit B.* Ka aplikuar për herë të parë në Shqipëri diagnostikimin imunologjik të sëmundjes celiake si dhe përcaktimin e shënjesve diagnostike të gjëndjeve alergjike nëpërmjet përcaktimit të Imunoglobulinave E specifike in vitro.

Në sëmundjet autoimune kam realizuar Studimin e thelluar të shënjesve autoimune në sëmundjet autoimune organ-specifike si tiroiditi autoimun, diabeti juvenil insulino-vartës, hepatitet autoimune, artriti reumatoid etj.

Ka realizuar me sukses për herë të parë në vëndin tonë tipizimin indor të sistemit HLA me metodat e serologjisë dhe të biologjisë molekulare duke bërë të mundur realizimin e transplanteve të organeve dhe qelizave në Shqipëri. Në këtë fushë ka vënë në jetë ekzaminimin e crossmatch dhurues-marrës në transplantet e organeve me disa metoda.

Ka realizuar studimin e parë gjenetik në popullatën shqiptare në Shqipëri dhe Kosovë mbi polimorfizmin gjenetik të sistemit HLA në këtë popullatë dhe krahasimin e këtij polimorfizmi me popullatat e tjera fqinje dhe europiane. Gjithashtu ka kontribut origjinal shkencor në studimin e lidhjes gjenetike midis sistemit HLA dhe sëmundjeve autoimune si artriti reumatoid dhe diabeti juvenil insulino-vartës në popullatën shqiptare.

Për aktivitetin e tij në fushën e Imunologjisë së Transplanteve ka marrë nga ana e Bordit European të Kualifikimit në Imunologjinë e Transplantit në Bruksel: *"Diplomën Honorifike Europiane të Specializimit në Imunologjinë e Transplanteve, Histokompatibilitet dhe Immunogjenetikë"*.

Rezultatet e studimeve të mësipërme janë publikuar në revista të njohura ndërkombëtare me impakt faktori si: "*Human Immunology*"; "*Tissue Antigens*"; "*International Journal of Immunogenetics*"; "*Rheumatology International*"; "*International Journal of Infectious Diseases*"; "*Clinical and Experimental Rheumatology*"; "*Leprosy Review*"; "*Clinical and Experimental Immunology*"; "*Biomedicine and Pharmacotherapy*"; "*Balkan Medical Journal*"; "*Macedonian Journal of Medical Sciences*"; "*Turkish Journal of Immunology*"; si dhe në revista shqiptare në gjuhën angleze si "*Journal of Natural and Technical Sciences*"; "*Albanian Journal of Medical and Health Sciences*"; "*Albanian Medical Journal*".

Ka marrë pjesë në projekte kërkimore shkencore ndërkombëtare sic është projekti "COST" i Bashkimit Europian: "*A European network of the HLA diversity for histocompatibility, clinical transplantation, epidemiology and population genetics (HLA-NET)*" drejtuar nga Universiteti i Gjenevës, Zvicër (2010 - 2014).

Ka marrë pjesë në "*Projektin studimor mbi mangësitë imunitare primare te njeriu*" në Europën Lindore, Qëndrore dhe Juglindore (Project J).

Sherbimi i Imunologjisë që drejton është i vetmi në vënd që është inkorporuar në një projekt kontrolli të cilësisë në tipizimin e sistemit HLA me biologji molekulare. Projekti drejtohet nga *ISTITUTO SUPERIORE DI SANITA*, Romë, Itali.

Një projekt tjetër ku ka marrë pjesë është projekti "*HigherKOS in BIOBANKING*". Ky projekt drejtohet nga Universiteti Mjekësor i Graz-Austri dhe përfshihej dhe Universiteti i Prishtinës, Instituti i Shëndetit Publik, Prishtinë dhe Sherbimi i Imunologjisë dhe Pajtueshmërisë Indore, Universiteti i Mjekësisë, Tirane (2013 - 2014).

Brenda vendit ka drejtuar projektin kombëtar 2011-2014 të AKTI (Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit) me titull: "*Polimorfizmi gjenetik i sistemit HLA në popullatën shqiptare dhe roli i markuesve imunologjikë dhe imunogjenetikë në realizimin e transplanteve dhe diagnozën e sëmundjeve autoimmune*".

Aktualisht drejton projektin "Aplikimi i imunocitometrisë me fluks në studimin e funksionit fagocitar dhe limfocitar si dhe në imunofenotipizimin qelizor të nyjeve limfatike" miratuar nga AKSHI në kuadrin e "Paktit për Universitetin" 2019-2021.

Që nga viti 2014 është kryeredaktor i Revistës shkencore zyrtare të Universitetit të Mjekësisë të Tiranës "*Albanian Journal of Medical and Health Sciences*" si dhe Kryetar i Këshillit të Botimeve të këtij Universiteti. Aktualisht është president i *Shoqatës Shqiptare të Imunologjisë, Immunopatologjisë dhe Pajtueshmërisë Indore*; Anëtar i *Shoqatës Shqiptare të Alergollogjisë dhe Imunologjisë Klinike*; Anëtar i *Shoqatës Shqiptare të Pediatriisë*; Anëtar i *Shoqatës Europiane të Alergollogjisë dhe Imunologjisë Klinike (European Society of Allergology and Clinical Immunology)*; Anëtar i *Unionit nderkombetar i luftes kunder Kancerit (International Union Against Cancer)*; Anëtar i *Federates Europiane te Immunogjenetikes (European Federation of Immunogenetics)*.; Anëtar i *Shoqatës Europiane te Transplantit te Organeve (ESOT: European Society of Organ Transplantations)*.

Si aktivitet shkencor të botuar gjatë punës së tij kërkimore ka rreth 150 punime shkencore ndër të cilat: Tekstin e përshtatur: "*Imunologjia e përgjithshme*"; Tekstin origjinal "*Imunologjia*" si tekst bazë për studentet universitare dhe pasuniversitare në Fakultetin e Mjekësisë. Është bashkëautor në tekstin "*Pediatrics*" për studentët e Fakultetit të Mjekësisë.

Ka publikuar artikuj shkencore dhe referime shkencore me punime origjinale në shtypin shkencor ndërkombëtar dhe atë brenda vendit si dhe në mbledhje shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare nga të cilat 50 Artikuj shkencorë të botuar në revista kombëtare dhe ndërkombëtare. Nga këto 17 artikuj janë publikuar në revista ndërkombetare të indeksuara në regjistra ndërkombëtare dhe me faktor impakti. Ka 78 Referate dhe kumtesa në konferenca dhe kongrese shkencore ndërkombëtare dhe kombëtare si dhe ka realizuar apo në realizim 6 projekte shkencore në rang kombëtar dhe ndërkombëtar. Ne regjistrat shkencore ndërkombëtare (Mendeley - Elsevier, Google Scholar, Research Gate) ka një h-index të kalkuluar 8.0 dhe 331 citime.

Ne vitin 2018 i është akorduar nga Presidenti i Republikës së Francës titulli honorifik "*KALORËS I URDHËRIT KOMBËTAR TË LEGJIONIT TË NDERIT*".